




REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK	Nr. Prot. 03-02/4823/16
Nr.faq	Dat. 20.12.2016
Broj stranica 02	Datum 20.12.2016
Nr. pages	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.12.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-2768/16, për z. Durim Krasniqi – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Malishevës, për shkak se ai ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-2768/16, për z. Durim Krasniqi – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Malishevës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në bizneset private “UNIVERS” SH.P.K., “ASC” SH.P.K dhe N.N. “ABM - TIKI”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast z. Krasniqi, së pari është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit pas së cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e AKK-së.

z. Krasniqi është njoftuar se nuk mund të ushtroj funksione menaxheriale në biznese private, krahas funksionit publik të zyrtarit të lartë, ndërsa ai ka deklaruar se do të largohet nga funksioni publik.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci formularin e plotësuar, “Deklarim pas largimit nga funksioni”, si dhe vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me të cilat dëshmohet se zyrtari i lartë z. Durim Krasniqi ka dhënë dorëheqje të përvokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës për shkak të konfliktit të interesit. Me këtë ai ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor Agjencisë kundër Korrupsionit

Shaip Havolli

